



Nr. i Protokollit

01-8711

Data

26.01.2022

Në bazë të dispozitave të nenit 21, neni 25 paragrafi 25.2 pika h) të Ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15 qershor 2008), respektivisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/30 maj 2012), Komisioni i Auditimit i Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A, në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur më datë: 25.01.2022 mori këtë

VENDIM

- I. Zyrtar i Auditimit të Brendshëm i Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A.me seli në Prishtinë, përzgjedhet z.Sokol Duraku nga Prishtina Master në Financa dhe Banka, Auditor i Brendshëm i Çertifikuar.
- II. Obligohet Divizioni i Burimeve Njerëzore t'i kryej të gjitha procedurat e parapara me Rregulloren nr. 01-02-1380/1 datë 20.12.2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin me përshkrim të detyrave të punës të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A. Prishtinë.
- III. Paga e Auditorit të Brendshëm të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A. në Prishtinë, caktohet në bazë të dispozitave të nenit 22 parag.22.1, 22.2 dhe 22.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe Rregulloren nr. 01-02-1380/1 datë 20.12.2019 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin me përshkrim të detyrave të punës të Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A. Prishtinë.

Arsyetimi

Në bazë të konkursit të shpallur me datën 09.12.2021 në faqen zyrtare të NPB-re www.npbanesore.com për pozitën Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në NPB-së, kanë konkuruar 6(gjashtë) kandidatë për këtë pozitë nga të cilët vetëm 4 (katër)kandidatë I kanë plotësuar kriteret e konkursit. Komisioni i Auditimit i Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A. në Prishtinë gjatë intervistimit të kandidatëve dhe vlerësimit të tyre ka bërë

përzgjedhjen e kandidatit z.Sokol Duraku nga Prishtina, Master në Financa dhe Banka, Auditor I Brendshëm I Çertifikuar.

Nga sa u tha u vendos si në dispozitiv të vendimit.

Këshillë Juridike: Nëse konsideroni që procedura e Rekrutimit nuk është kryer konform rregullativës juridike në fuqi, keni të drejtë ankese në Komisionin e Ankesave në Ndërmarrjen Publike Banesore, në afat prej 8 ditësh nga dita e shpalljes së këtij njoftimi.

Vendimi I Dorëzohet:

- Të Përzgjedhurit
- Anëtarëve të Komisionit
- Burimeve Njerëzore
- Arkivit të Ndërmarrjes



Alban Ramosaj

Kryesues I Komisionit të Auditimit